



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01- 9769/20
Kaçanik, 21.05.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **III-të** (Tretë) e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 21 Maj 2020. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e kuvendit të komunës, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përberja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Albana Troni.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Kryetari i Komunës –Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive; Bahri Selimi, Ukshin Qallaku, ndërkaq nga zyrtarët komunal ishin, Arbnora Kuka dhe Ilirjana Berisha.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfëre Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e III-të (Tretë) të Rregullt të KPF-a për vitin 2020, data 21 Maj, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF -s;
2. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara në buxhetin e Komunës për në vitin 2020;
3. Propozim Vendim për Rialokim të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020;
4. Propozim Vendim për lirim nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2020, si dhe lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore deri në përfundim të Pandemisë COVID – 19;
5. Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës – Azem Guri;
6. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës – Bekim Musliu;
7. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës – Nusret Tifeku.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit është njëzëri me punuar me këtë rend pune. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, e,

APROVOJ

Rendin e propozuar të punës, në përbërje 7 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhës së II-të (Dytë) të Rregullt të KPF-a, mbajtur me datë 24 Shkurt 2020 / Lënd: 01Nr. 060/01- 4996/20.

2. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara në buxhetin e Komunës për në vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, për sqarime të nevojshme, fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Sqaroj për shumën e mjeteve të cilat do të bartën në vitin 2020 janë: 268.882.77€, e cila shumë pas bartjes, buxheti i vitit 2020 është në shumë, 9,269.412.77€. Mjetet e bartura do të shpenzohen për: Mallra e shërbime, 0.69€, 66,000€ për subvencione dhe transfere, ku nga kjo shumë, 50.000€ do të bartën OJQ “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e shtëpive të banimit në komunën tonë si participim për një shtëpi 5.000€, ndërkaq për Investime kapitale shuma, 202,882.08€.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka me këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Të pika 1 e Propozim Vendimit shënohet viti 2019, ku është arsyeja që shënohet viti 2019, pasi që kemi të bëjmë me bartje të mjeteve buxhetore të vitit 2020, a mos është bërë ndonjë gabim teknik.

z. Bahri Selimi, Procedura është ashtu, njëherë shënohen mjetet buxhetore të ngelura nga vitet paraprake, pastaj shënohen viti aktual në të cilin bartën mjetet buxhetore për shpenzim.

z. Selim Reka, Është mirë që këto mjete buxhetore bartën nga viti në vit për shpenzim, ndërkaq të Investimet kapitale, ka pasur hapësirë me proceduar mjete buxhetore në nën-programin buxhetor të arsimit, kur dihen nevojat e shkollave për mjete buxhetore.

z. Bahri Selimi, Për vitin 2020 janë paraparë projekte që do të realizohen me mjete buxhetore të këtij viti, ashtu që me buxhet janë të parapara 50.000€, ku do të realizohen shuma 10.000€ për kabinete shkollore dhe shuma tjetër për projekte të tjera në shkollave.

z. Selim Reka, Situata e krijuar për shkak të pandemisë Covid-19, shkollat kanë nevojë për dezinfektim të objekteve shkollore dhe nevoja të tjera.

z. Bahri Selimi, Fondi i ndarë 100,000€ për menaxhimin e Covid-19, parasheh edhe dezinfektimet e objekteve shkollore dhe nevojave të tjera të shkollave.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendim të shkoj në procedurë të KK. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara në buxhetin e Komunës për në vitin 2020; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Vendim për Rialokim të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme, fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Sqaroj për rialokimin e mjetetve buxhetore, arsyet e mbetjes së mjeteve nga projektet kapitale dhe bartjen e tyre në projekte të tjera kapitale. Disa mjete janë shpenzuar për procedura përmbarimore, rëngën të QKMF e kështu me radhë, kështuqë është ndier nevoja e rialokimit të mjeteve buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit, Me Statut të Qendrës së Mjekësë Familjare në Kaçanik, ambulanca në Doganaj është paraparë të jetë QKMF. Objekti i ambulancës në Doganaj duhet me u zhvendosur, sepse ka me u ndërtuar shkolla në atë lokacion. Për sivjet nuk mundet me u ndërtuar ai objekt, ndërkaq si kod duhet me ekzistuar. Shuma e ndarë për atë projekt është 65.000€.

z. Ekrem Kyçyku, A mos është arsyeja e mosrealizimit të projektit të objektit të QMF në Doganaj për shkak të pagesave përmbarimore që është dashur të paguhet nga komuna për humbjen e kontesteve me gjykatat.

Kryetari i Komunës, Projekti i QMF në Doganaj, është shtyrë për shkak të caktimit të një lokacioni tjetër. Kodi për këtë projekt do të figuroj në listën e prioriteteve dhe do të realizohet pas caktimit të lokacionit. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni të pajtimit që ky propozim vendim t'i kaloj KK në procedurë për shqyrtim dhe aprovim; Rezultati i votimit është njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendim për Rialokim të mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2020; dhe i njëjti i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendim për lirim nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2020, si dhe lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore deri në përfundim të Pandemisë COVID – 19;

Kryesuesi i Kuvendit, Ky propozim Vendim ka ardhur nga Zyra e Kryetarit të Komunës. Për Sqarime të nevojshme, fjalën e ka Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Sqaroj së për shkak të gjendjes së krijuar si rezultat i pandemisë, e kemi parë të arsyeshme me i liruar nga qiraja komunale shfytëzuesit e tyre për vitin 2020 dhe lirim nga disa pagesa shëndetësore të gjithë qytetarët e komunës deri me përfundim të pandemisë.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Nexhat Loku, Sa është shuma për 1 vit nga ky lirim i shfytëzuesve të pronës komunale dhe lrimi nga pagesat shëndetësore?

z. Bahri Selimi, Lidhur me pyetjen e z. Nexhat Loku, shuma e lirit nga pagesa është diku 20.000€ për një vit.

z. Selim Reka, Ky Propozim Vendim është i qëlluar, kështu që unë jam me mbështetur lirim nga pagesa e qirasë shfytëzuesit e pronës komunale dhe lirim nga disa pagesa shëndetësore të gjithë qytetarët e komunës, përcaktuar si në propozim vendim.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo çështje t'i kaloj Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendim për lirim nga qiraja komunale për shfytëzuesit e pronës komunale për vitin 2020, si dhe lirim nga pagesa e shërbimeve shëndetësore deri në përfundim të Pandemisë COVID – 19; dhe i njëjti i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës – Azem Guri;

Kryesuesi i Kuvendit, A paraqet problem që prona është e përbashkët, a dihet se cilës pronë i ndërrohet destinimi, sepse me ia ndërruar destinimin një prone, prona duhet të jetë në emër të pronarit.

z. Ukshin Qallaku, Jo nuk paraqet ndonjë problem ndërrimi i destinimit të pronës në fjalë ashtu siç është përcaktuar në lëndë, sepse dihet se cilës pronë i ndërrohet destinimi.

Kryesuesi i Kuvendit, Mirë është këto çështje me u rregulluar që pronat me qenë në emër të pronarit në mënyrë që me pasur me lehtë ne kur të marrim vendim. Atëherë diskutime të tjera nuk ka, kështu që këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës – Azem Guri; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës – Bekim Musliu;

Kryesuesi i Kuvendit, Për këtë pikë e hapi diskutimin: Meqë nuk u paraqit kush për diskutim, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF mori këtë,

VENDIM

Me të cilin MIRATOHET Propozim Vendimi i DUKMM 06Nr. 350/01-9670/20 -Për Lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të BEKIM MUSLIU nga fshati Ferizaj në sipërfaqen, 6669m², në Parcelën Kadastrale Nr. P-70917086-01316-0, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore, Arë e klasës 5 (Pestë).

7. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës – Nusret Tifeku;

Kryesuesi i Kuvendit, Për këtë pikë e hapi diskutimin: Meqë nuk u paraqit kush për diskutim, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF mori këtë,

VENDIM

Me të cilën MIRATOHET Propozim Vendimi i Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit 06Nr. 350/01-9657/20 -Për Lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të NUSRET TIFEKU nga fshati Vatë, në sipërfaqen, 500m², në Parcelën Kadastrale Nr. P-70917086-01211-2 Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore, Livadh i klasës 5 (Pestë).

Kryesuesi i Kuvendit, Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:25. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët.

Mbledhja e Kuvendit të Komunës është caktuar për datë, 27 Maj 2020, në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



Kemal Mërseli